



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT
DREJTORIA JURIDIKE DHE E PROKURIMEVE**

Nr. ____ Prot

Tiranë: ____ / ____ / 2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjete transporti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP):

Kamionë pune 42415200-0; Kamionçina 34136200-1; Kamionë ngritës pirun 42415110-2;

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 54,661,667 (pesëdhjetë e katër milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, ose 585,995.57 (pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë euro e pesëdhjetë e shtatë cent) euro pa TVSH, bazuar ne kursin e kembimit te dates 04.08.2026.

“Procedurë e hapur”, mbi kufurin e lartë monetar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimit dhe Gjellbërimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licencë të vlefshme, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me kod VII.3.B.1/d, për veprimtarinë “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”, në përputhje me ligjin nr. 9573, datë 03.07.2006, të ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 1546, datë 29.03.2016, “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”.

Argumentimi i kriterit: *Kërkesa për këtë licencë lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, i cili përfshin furnizimin dhe kalimin në pronësi të Autoritetit Kontraktor të mjeteve rrugore me motor. Ushtrimi i veprimtarisë së blerjes dhe shitjes së mjeteve me motor është veprimtari e rregulluar dhe kryhet nga subjekte të pajisura me licencën përkatëse.*

Licenca provon se operatori ekonomik ose anëtar i bashkimit që do të realizojë shitjen e mjeteve është ligjërisht i autorizuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe plotëson kushtet teknike, profesionale dhe administrative të parashikuara nga legjislacioni sektorial. Kriteri është proporcional dhe i lidhur me objektin e kontratës, pasi nuk kërkon një kapacitet shtesë të palidhur me furnizimin, por autorizimin ligjor të domosdoshëm për kryerjen e vetë veprimtarisë që përbën objektin e prokurimit. Teksti i Udhëzimit nr. 1546/2016.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, pika 2/a e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.*

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar te arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që

referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a, Autoriteti Kontraktor nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së fondit limit në kërkesën për kualifikim, por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të kontrates/lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore. Kjo vlere është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohej një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.*

Referuar Nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i)totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të lotit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si vërtetime/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë, për të gjitha mjetet që oferton, katalog teknik/broshurë të lëshuar nga prodhuesi dhe/ose lejen përkatëse të qarkullimit, duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mjetin e ofruar, si dhe të dhënat dhe specifikimet teknike përkatëse, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e dokumenteve të tenderit.

Për vinçin duhet të paraqitet dokumentacioni teknik dhe diagrama zyrtare e ngarkesës së prodhuesit, si dhe deklarata e konformitetit e prodhuesit dhe/ose certifikata e konformitetit e lëshuar nga një organ i pavarur dhe i akredituar, sipas rastit, nga ku të vërtetohet përputhshmëria me Direktivën Evropiane 2006/42/EC dhe standardin EN 12999:2020 ose ekuivalentin e tij.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të identifikojë qartë markën, modelin dhe tipin e mjetit dhe të vinçit. Kur dokumentacioni paraqitet në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohet me përkthimin përkatës në gjuhën shqipe, sipas kërkesave të dokumenteve standarde të tenderit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar nëse operatori ekonomik ofron mjete dhe pajisje që përmbushin karakteristikat teknike, funksionale dhe të sigurisë të përcaktuara në specifikimet teknike, si dhe për të krahasuar në mënyrë objektive kërkesat e dokumenteve të tenderit me të dhënat teknike të mjeteve të ofruara.

Paraqitja në mënyrë alternative e katalogut teknik/broshurës së prodhuesit dhe/ose lejes përkatëse të qarkullimit është e nevojshme për identifikimin e markës, modelit, tipit dhe parametrave teknikë të mjeteve. Pranimi i këtyre dokumenteve në mënyrë alternative merr në konsideratë faktin se të dhënat teknike mund të pasqyrohen në dokumente të ndryshme, veçanërisht kur objekt prokurimi janë mjete të përdorura, duke shmangur vendosjen e kërkesave të panevojshme ose kufizuese për operatorët ekonomikë.

Markimi i qartë dhe i dallueshëm i mjetit dhe i parametrave teknikë përkatës në dokumentacionin e paraqitur është i nevojshëm për të mundësuar identifikimin e ofertës teknike dhe verifikimin e saj pa paqartësi. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktor mund të evidentojë konkretisht se cilat të dhëna të katalogut, broshurës ose lejes së qarkullimit i përkasin mjetit të ofertuar dhe nëse ato përputhen me kufijtë minimalë ose maksimalë të përcaktuar në specifikimet teknike.

Për vinçin hidraulik ngarkues, kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit lidhet me faktin se, ndryshe nga automjetet që mund të jenë të përdorura, vinçi i montuar në mjet kërkohet të jetë i ri, i prodhimit të vitit 2026 dhe me zero orë pune. Për rrjedhojë, autorizimi i prodhuesit është i nevojshëm për të provuar se operatori ekonomik është i autorizuar të ofrojë dhe të furnizojë vinçin e propozuar, si dhe se pajisja sigurohet nëpërmjet një burimi të identifikueshëm dhe të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi i prodhuesit i shërben Autoritetit Kontraktor për të verifikuar origjinën dhe autenticitetin e vinçit, identifikimin e markës, modelit dhe tipit të tij, si dhe saktësinë e dokumentacionit teknik që shoqëron pajisjen. Nëpërmjet këtij dokumenti provohet gjithashtu mundësia e operatorit ekonomik për të siguruar dokumentacionin zyrtar teknik, dokumentacionin e konformitetit, mbështetjen teknike dhe kushtet përkatëse të garancisë. Kërkesa për autorizimin e prodhuesit është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është proporcionale me natyrën e furnizimit, pasi vinçi përbën një makineri të re, të specializuar dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë e përdoruesve dhe të proceseve të punës. Për këtë arsye, autorizimi i prodhuesit nuk kërkohet për automjetet e përdorura, por vetëm për vinçin e ri që do të montohet në kamionin vetëshkarkues.

Për vinçin hidraulik ngarkues, kërkesa për paraqitjen e diagramës zyrtare të ngarkesës së prodhuesit është e domosdoshme, pasi vetëm evidentimi i kapacitetit maksimal të tij nuk është i mjaftueshëm për të provuar aftësinë reale ngritëse. Kapaciteti ngritës i vinçit ndryshon në varësi të largësisë së ngarkesës nga aksi i rrotullimit, shtrirjes së krahut teleskopik dhe konfigurimit përkatës të punës. Diagrama zyrtare e ngarkesës, e lëshuar nga prodhuesi, mundëson verifikimin objektiv dhe të matshëm të kapacitetit ngritës të vinçit në secilën gjatësi pune të kërkuar në specifikimet teknike. Nëpërmjet saj verifikohet nëse vinçi ruan kapacitetin e kërkuar në hapjen e parë, të dytë dhe të tretë të krahut teleskopik dhe nëse është funksionalisht i përshtatshëm për ngarkimin dhe largimin e mbetjeve voluminoze, trungjeve të pemëve, materialeve të rënda dhe ngarkesave të tjera që krijohen gjatë proceseve të punës së Autoritetit Kontraktor.

Direktiva Evropiane 2006/42/EC përcakton kërkesat thelbësore për shëndetin dhe sigurinë e makinerive, ndërsa standardi EN 12999:2020 trajton kërkesat e sigurisë për vinçat ngarkues. Deklarata e konformitetit e prodhuesit dhe/ose certifikata e konformitetit e lëshuar nga një organ i pavarur dhe i akredituar, sipas rastit, mundëson verifikimin dokumentar dhe objektiv se vinçi i ofruar përmbush kërkesat e mësipërme të sigurisë dhe performancës ose kërkesa teknike ekuivalente. Pranimi në mënyrë alternative i deklaratës së konformitetit të prodhuesit dhe/ose i certifikatës së konformitetit të lëshuar nga një organ i pavarur dhe i akredituar shmang kufizimin e panevojshëm të konkurrencës, duke lejuar paraqitjen e dokumenteve të vlefshme të konformitetit sipas mënyrës në të cilën produkti është vendosur në treg. Gjithashtu, përdorimi i shprehjes “ose ekuivalent” lejon ofertimin e standardeve ose zgjidhjeve të tjera teknike që garantojnë një nivel të barasvlershëm sigurie dhe performance.

Për autokullat, paraqitja e diagramës zyrtare të ngarkesës dhe të punës së prodhuesit është e nevojshme për të verifikuar marrëdhënien ndërmjet lartësisë së punës, shtrirjes horizontale të krahut, kapacitetit mbajtës të koshit dhe konfigurimit të stabilizatorëve. Vetëm deklarimi i lartësisë maksimale të punës nuk është i mjaftueshëm për të provuar se autokulla ruan kapacitetin, shtrirjen dhe qëndrueshmërinë e kërkuar në të gjithë zonën e saj të punës. Diagrama zyrtare e prodhuesit mundëson verifikimin nëse autokullat përmbushin lartësitë e punës dhe shtrirjet horizontale të kërkuara, si dhe nëse ruajnë kapacitetin mbajtës të koshit në konfigurimet përkatëse të stabilizatorëve. Nëpërmjet këtij dokumenti verifikohet gjithashtu zona e sigurt e operimit të platformës, kufizimi i lëvizjeve në varësi të ngarkesës në kosh dhe përshtatshmëria e mjetit për kryerjen e ndërhyrjeve në pemët e larta dhe në hapësirat urbane. Kërkesa për diagramën zyrtare të autokullave lidhet drejtpërdrejt me parametrat e specifikimeve teknike dhe është e nevojshme për vlerësimin objektiv të sigurisë, stabilitetit dhe performancës së platformave ajrore. Paraqitja e dokumentit zyrtar të prodhuesit shmang mbështetjen vetëm në deklaratimet e operatorit ekonomik dhe mundëson verifikimin e ofertave mbi bazën e të dhënave teknike të matshme dhe të krahasueshme.

Duke qenë se procedura zhvillohet si procedurë e hapur ndërkombëtare, dokumentacioni teknik dhe dokumentet e ofertës mund të paraqiten në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze. Dokumentet e paraqitura në gjuhë të tjera të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin përkatës në gjuhën shqipe ose angleze, sipas përcaktimeve të dokumenteve standarde të tenderit.

Në përfundim, dokumentacioni i kërkuar është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është i nevojshëm për identifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të ofertuar, verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike dhe garantimin e sigurisë dhe funksionalitetit gjatë përdorimit. Kërkesat janë formuluar duke pranuar dokumente alternative dhe standarde ekuivalente, me qëllim ruajtjen e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vetëdeklarim për secilin mjet të ofruar, në të cilin të përcaktojnë të paktën: llojin e mjetit, markën, modelin, vitin e prodhimit, dhe kilometrat e përshkuara në datën e paraqitjes së ofertës, shoqëruar me foto për të dhënat e kilometrave. Të dhënat e deklaruara, përfshirë kilometrat e përshkuara, do të verifikohen nga Autoriteti Kontraktor në momentin e dorëzimit të mjeteve. Mjetet duhet të përmbushin kufijtë maksimalë të

kilometrave të përcaktuar në specifikimet teknike. Kilometrat shtesë të krijuara ndërmjet ofertimit dhe dorëzimit duhet të jenë vetëm ato të nevojshme për transportin dhe dorëzimin e mjetit.

Në rast se gjatë verifikimit konstatohet se të dhënat e deklaruara nuk përputhen me mjetin e dorëzuar ose se kilometrat tejkalojnë kufirin maksimal të përcaktuar, mjeti nuk do të pranohet nga Autoriteti Kontraktor. Deklarimi i të dhënave të pavërteta sjell pasojat e parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe në dokumentet e tenderit.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.*

Paraqitja e vetëdeklarimit është e nevojshme për identifikimin e qartë të secilit mjet të ofruar dhe për evidentimin paraprak të markës, modelit, vitit të prodhimit, numrit të shasisë dhe kilometrave të përshkuara. Këto të dhëna i mundësojnë Autoritetit Kontraktor të vlerësojë nëse mjeti i propozuar përmbush kufijtë e përcaktuar në specifikimet teknike.

Përdorimi i vetëdeklarimit në fazën e ofertimit shmang ngarkimin e operatorëve ekonomikë me dokumentacion të panevojshëm, duke ruajtur njëkohësisht përgjegjësinë e tyre për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të deklaruara.

Kilometrat e përshkuara përbëjnë një tregues të rëndësishëm të nivelit të përdorimit dhe konsumimit të mjeteve. Për këtë arsye, të dhënat e deklaruara do t'i nënshtrohen verifikimit fizik nga Autoriteti Kontraktor në momentin e dorëzimit. Pranimi i mjetit do të kryhet vetëm nëse kilometrat e konstatuara përputhen me vetëdeklarimin dhe nuk tejkalojnë kufirin maksimal të përcaktuar në specifikimet teknike, me përjashtim të kilometrave të arsyeshme të krijuara për transportin dhe dorëzimin e tij.

Kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, proporcional dhe i matshëm, si dhe garanton që Autoriteti Kontraktor të pranojë mjete me nivelin e përdorimit dhe gjendjen teknike të kërkuar.

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëdeklarim se garanton motorin e secilit mjet të ofruar për jo më pak se 6 (gjashtë) muaj nga marrja në dorëzim. Gjatë kësaj periudhe, diagnostikimi dhe eliminimi i defekteve të motorit, përfshirë punën dhe pjesët e këmbimit, do të kryhen pa pagesë. Përjashtohen konsumimi normal dhe defektet që provohet se janë shkaktuar nga aksidenti, pakujdesia, mungesa e mirëmbajtjes ose keqpërdorimi i mjetit.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Vendorsja e këtij kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për të garantuar funksionimin normal të motorit të mjeteve të përdorura për një periudhë jo më të shkurtër se 6 (gjashtë) muaj nga marrja e tyre në dorëzim, si dhe eliminimin pa pagesë të defekteve që mund të shfaqen gjatë përdorimit normal. Afati i kërkuar është i arsyeshëm dhe proporcional me natyrën e mjeteve objekt prokurimi, ndërsa përjashtimi i konsumimit normal dhe i defekteve të shkaktuara nga aksidenti, mungesa e mirëmbajtjes ose keqpërdorimi shmang ngarkimin e operatorit ekonomik me përgjegjësi që nuk lidhen me gjendjen teknike të mjeteve në momentin e dorëzimit.*

5. Për përmbushjen e detyrimeve të garancisë së përcaktuar më sipër, operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion të paktën një servis, në pronësi, me qira, në huapërdorje ose në një nga format e tjera të disponimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Për vërtetimin e përmbushjes së këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë pronësie, kontratë qiraje, kontratë huapërdorjeje ose çdo dokument tjetër të vlefshëm, nëpërmjet të cilit provohet e drejta e pronësisë ose e përdorimit të servisit, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Dokumentacioni që provon të drejtën e përdorimit duhet të jetë i vlefshëm për një periudhë jo më të shkurtër se afati i garancisë së kërkuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77, pika 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 40, pika 5, shkronja “a”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, dispozita që i japin të drejtë Autoritetit Kontraktor të kërkojë dëshmi për kapacitetet teknike, mjetet, pajisjet dhe strukturat që operatori ekonomik ka në dispozicion për realizimin e kontratës. Kërkesa mbështetet gjithashtu në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, konkretisht në nenin 149, i cili përcakton përmbajtjen e së drejtës së pronësisë; nenet 304 dhe 305, që rregullojnë posedimin dhe posedimin e ligjshëm të fituar nga pronari në bazë të një veprimi juridik; nenin 801, që përcakton kontratën e qirasë si dhënien e një sendi në gëzim të përkohshëm kundrejt një shpërblimi; si dhe nenin 901, që rregullon dhënien e një sendi në përdorim të përkohshëm nëpërmjet kontratës së huapërdorjes. Këto dispozita përcaktojnë format ligjore nëpërmjet të cilave operatori ekonomik mund të provojë pronësinë ose të drejtën e ligjshme të përdorimit të servisit.

Vendosja e këtij kriteri lidhet drejtpërdrejt me detyrimin e operatorit ekonomik për të garantuar motorin e secilit mjet të ofruar për një periudhë jo më të shkurtër se 6 (gjashtë) muaj nga data e marrjes në dorëzim. Përmbushja efektive e këtij detyrimi kërkon që operatori ekonomik të ketë në dispozicion një ambient të përshtatshëm për diagnostikimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e motorëve, në mënyrë që defektet e mbuluara nga garancia të evidentohen dhe të eliminohen brenda një kohe të arsyeshme dhe pa kosto për Autoritetin Kontraktor.

Disponueshmëria e servisit i garanton Autoritetit Kontraktor se detyrimi i garancisë nuk mbetet vetëm në nivel deklarativ, por mbështetet në një kapacitet teknik konkret, të identifikueshëm dhe të disponueshëm gjatë gjithë periudhës së garancisë. Nëpërmjet dokumentacionit të pronësisë, qirasë, huapërdorjes ose një forme tjetër të ligjshme të përdorimit, provohet se operatori ekonomik ka të drejtën juridike dhe mundësinë faktike për ta përdorur servisin për realizimin e ndërhyrjeve të nevojshme.

Kërkesa që dokumentacioni të jetë i vlefshëm për një periudhë jo më të shkurtër se afati i garancisë është e nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e disponibilitetit të servisit dhe për të shmangur situatën në të cilën e drejta e përdorimit përfundon përpara përmbushjes së detyrimeve të marra nga operatori ekonomik.

Kriteri është proporcional dhe nuk kërkon që servisi të jetë detyrimisht në pronësi të operatorit ekonomik. Pranimi i qirasë, huapërdorjes dhe formave të tjera të ligjshme të disponimit u mundëson operatorëve ekonomikë të provojnë kapacitetin teknik nëpërmjet alternativave të parashikuara nga legjislacioni civil, duke ruajtur konkurrencën dhe trajtimin e barabartë.

Për sa më sipër, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin dhe kushtet e kontratës, është i nevojshëm për realizimin efektiv të garancisë së motorëve dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u siguruar se operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe mjediset e përshtatshme për diagnostikimin dhe eliminimin pa pagesë të defekteve të mbuluara nga garancia.

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim, nëpërmjet së cilës merr përsipër dorëzimin e mjeteve të treguara dhe të regjistruara në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të pajisura me të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor të nevojshëm për qarkullim, në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Në çmimin e ofertuar duhet të përfshihen të gjitha shpenzimet përkatëse, përfshirë detyrimet doganore, regjistrimin e mjeteve, pajisjen me targa, sigurimin e detyrueshëm, kontrollin teknik, sipas rastit, si dhe çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për dorëzimin e mjeteve të regjistruara në emër të Autoritetit Kontraktor dhe të gatshme për qarkullim rrugor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe në nenin 40 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u garantuar se mjetet do të dorëzohen të regjistruara në pronësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit, të pajisura me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor dhe të gatshme për qarkullim dhe përdorim të menjëhershëm.

Përfshirja në çmimin e ofertës e detyrimeve doganore, regjistrimit, targave, sigurimit të detyrueshëm, kontrollit teknik, sipas rastit, dhe e çdo shpenzimi tjetër përkatës është e nevojshme për të përcaktuar qartë përgjegjësinë e operatorit ekonomik dhe për të shmangur krijimin e kostove shtesë për Autoritetin Kontraktor pas lidhjes së kontratës.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe garanton që furnizimi të konsiderohet i përfunduar vetëm pasi mjetet të jenë regjistruar në emër të Autoritetit Kontraktor dhe të jenë juridikisht e teknikisht të gatshme për qarkullim rrugor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike për kamionçinat vetëshkarkuese treanëshe dhe kamionin vetëshkarkues me vinç janë përcaktuar në përputhje me nevojat funksionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjellbërimit për grumbullimin, ngarkimin, shkarkimin dhe transportimin e mbetjeve urbane, mbetjeve të krasitjeve, trungjeve, mbetjeve voluminoze dhe inerteve deri në landfill ose në destinacionet përkatëse.

Parametrat që lidhen me masën, kapacitetin e dobishëm të ngarkesës, fuqinë motorike, cilindratën, konfigurimin e akseve dhe sistemin vetëshkarkues treanësh janë përzgjedhur për të garantuar që mjetet të përballojnë ngarkesën dhe intensitetin e punës, duke ruajtur njëkohësisht manovrueshmërinë në rrugët urbane. Për kamionin me vinç, kapaciteti ngritës, shtrirja teleskopike dhe diagrama e ngarkesës janë përcaktuar në funksion të ngritjes dhe ngarkimit të materialeve të rënda dhe voluminoze, veçanërisht trungjeve të pemëve dhe mbetjeve që nuk mund të ngarkohen manualisht.

Kufijtë për vitin e prodhimit, kilometrat e përshkuara dhe standardin mjedisor synojnë sigurimin e mjeteve të përdorura me nivel të pranueshëm amortizimi, jetëgjatësi të dobishme dhe ndikim të kufizuar mjedisor. Specifikimet janë formuluar si kërkesa minimale ose maksimale të matshme dhe pa iu referuar një marke apo modeli të caktuar, me qëllim garantimin e funksionalitetit dhe ruajtjen e konkurrencës.

Specifikimet teknike për autokullën me lartësi pune 20–23 metra dhe autokullën me lartësi pune 25–30 metra janë përcaktuar në bazë të nevojës së Autoritetit Kontraktor për krasitjen, mirëmbajtjen dhe eliminimin e rrezikut nga pemët e larta në territorin e Bashkisë Tiranë, duke garantuar aksesin dhe sigurinë e punonjësve gjatë punës në lartësi.

Dy kategoritë e lartësisë janë përzgjedhur për të mbuluar ndërhyrje me nivele të ndryshme vështirësie. Autokulla 20–23 metra shërben për ndërhyrjet e zakonshme dhe për përdorim në rrugë ose hapësira më të kufizuara, ndërsa autokulla 25–30 metra nevojitet për pemët më të larta dhe për rastet kur kërkohet shtrirje më e madhe vertikale dhe horizontale. Kufiri maksimal prej 30 metrash është vendosur duke marrë në konsideratë se autokullat mbi këtë lartësi kanë zakonisht përmasa më të mëdha dhe mund të zënë një pjesë të konsiderueshme të karrexhatës.

Parametrat për lartësinë e punës, shtrirjen horizontale, kapacitetin e koshit, stabilizatorët, gjerësinë në pozicion transporti dhe gjerësinë gjatë punës janë përcaktuar për të garantuar një kombinim të përshtatshëm ndërmjet sigurisë, qëndrueshmërisë, funksionalitetit dhe kufizimit të pengesave në qarkullimin rrugor. Ndërsa viti i prodhimit, kilometrat dhe orët e punës synojnë sigurimin e mjeteve dhe platformave me nivel të kontrolluar përdorimi dhe amortizimi.

Specifikimet janë formuluar si kufij minimalë ose maksimalë objektivë dhe të verifikueshëm, pa iu referuar një prodhuesi, marke apo modeli të caktuar, duke lejuar pjesëmarrjen e mjeteve të ndryshme që përmbushin nevojën funksionale dhe nivelin e kërkuar të sigurisë.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT